

V E N D I M
Nr.61, datë 11.2.1993

**PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.129,
DATË 6.4.1985 "PËR MBROJTJEN E RRUGËVE DHE QARKULLIMIN RRUGOR"**

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve e të Komunikacioneve dhe të Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 6.4.1985, kreu XXX "Dëshmia e aftësisë për drejtimin e mjeteve" ndryshohet si më poshtë:

Neni 95

Dëshmitë e aftësisë për drejtimin e mjeteve janë:

1. Dëshmi aftësie e klasit "A" i lëshohet personit, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe di të drejtojë motomjetet, pesha e të cilave pa ngarkesë nuk i kalon 400 kg.

2. Dëshmi aftësie e klasit "B" i lëshohet personit, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe di të drejtojë çdo lloj automjeti, me përjashtim të klasit "A", me peshë maksimale të autorizuar deri në 3500 kg dhe me tetë vende, përveç shoferit. Automjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet prapa një rimorkio e lehtë.

3. Dëshmi aftësie e klasit "C" i lëshohet personit, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe di të drejtojë automjete për transport mallrash me peshë maksimale të autorizuar mbi 3500 kg. Automjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet prapa një rimorkio e lehtë. Kjo dëshmi aftësie është e vlefshme për të drejtuar mjete të klasit "B".

4. Dëshmi aftësie e klasit "D" i jepet personit, i cili ka mbushur moshën 23 vjeç, ka punuar si drejtues mjeti të klasit "C" jo më pak se 4 vjet dhe di të drejtojë çdo lloj automjeti për transport personash me mbi 8 vende, përveç shoferit. Kjo dëshmi aftësie është e vlefshme për të drejtuar mjete të klasit "B" dhe "C".

5. Dëshmi aftësie e klasit "E" i lëshohet personit, i cili ka mbushur moshën 24 vjeç, ka vjetërsi me patentë të klasit "D" jo më pak se një vit dhe di të drejtojë automjete të kategorive "B", "C" dhe "D", për të cilat drejtuesi i mjetit është i aftësuar t'i drejtojë me rimorkio jo të lehtë.

6. Dëshmi aftësie e klasit "F" i lëshohet personit, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe di të drejtojë çdo lloj traktori me rrota gome që tërheq një rimorkio me peshë me ngarkesë të plotë jo më të madhe se pesha e traktorit tërheqës.

Drejtimesit e mjeteve të shërbimit publik, taksi, autobuzë dhe kamionë, të përshtatur për transport njerëzish, nuk duhet të jenë më shumë se 60 vjeç dhe të jenë të pajisur me dëshmi aftësie të klasit "D" ose "E".

Personat që pajisen për herë të parë me dëshmi aftësie, duhet të kenë kryer shkollën 8-vjeçare, me përjashtim të atyre që në vitin 1970 kishin mbushur moshën 20 vjeç.

Fjala "peshë maksimale e autorizuar" e një mjeti transporti tregon peshën e tij bashkë me atë të ngarkesës kur është gati për udhëtim.

"Pesha maksimale" tregon peshën e ngarkesës të deklaruar të lejueshme nga autoriteti kompetent i organit të regjistrimit të mjetit të transportit.

Rimorkio të lehta janë ato, pesha maksimale e autorizuar e të cilave nuk i kalon 750 kg.

Neni 96

Dëshmitë e aftësisë vlerësohen në këtë mënyrë:

1. Dëshmitë e aftësisë të motoçikletave me e pa kosh dhe të motokarrove barazohen me dëshminë e klasit "A".

2. Dëshmia e aftësisë e klasit të katërt barazohet me dëshminë e klasit "B".

3. Dëshmia e aftësisë së klasit të tretë barazohet me dëshminë e klasit "C".

4. Dëshmia e aftësisë e klasit të parë e të dytë barazohet me dëshminë e klasit "E".
5. Dëshmia e aftësisë e traktorit rrugor barazohet me dëshminë e klasit "F".

Neni 97

Përgatitja e drejtuesve të mjeteve për të gjitha llojet e dëshmimeve të aftësive që përcaktohen në nenin 1, bëhet në shkollat e kurse përkundrejt pagesës nga vetë personat ose ndërmarrjet shtetërore e institucionet, kur këto i përgatitin për nevojat e tyre.

Shkollat dhe kurset organizohen nga ministrinë e institucionet e tjera qendrore në ndërmarrjet ose institucionet e tyre vartëse, si dhe nga personat juridikë privatë. Në të gjitha rastet ato fillojnë funksionimin pasi të merret leja përkatëse nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve dhe Ministria e Rendit Publik.

Neni 98

Përgatitja teoriko-praktike e kursantëve bëhet e detyrueshme në shkollat e kurse.

Koha e përgatitjes praktike të tyre përcaktohet në vartësi nga lloji i dëshmisë si më poshtë:

1. Për dëshminë e aftësisë të klasit "A" 12 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.
2. Për dëshminë e aftësisë të klasit "B" 36 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.
3. Për dëshminë e aftësisë të klasit "C" 56 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.
4. Për dëshminë e aftësisë të klasit "D" 20 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.
5. Për dëshminë e aftësisë të klasit "E" 20 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.
6. Për dëshminë e aftësisë të klasit "F" 30 orë, por jo më shumë se një orë në ditë.

Neni 99

Përgatitja, marrja në provë dhe pajisja me dëshminë e aftësisë përkatëse të personave për drejtimin e mjeteve shtytëse, gërmuese, të makinave bujqësore vetëlëvizëse e atyre speciale teknologjike bëhet nga vetë ministrinë e institucionet e tjera qendrore dhe ndërmarrjet e tyre vartëse.

Neni 100

Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve dhe Ministria e Rendit Publik të përcaktojnë me udhëzim kushtet që duhet të plotësojnë shkollat e kurset, përbërjen e funksionimin e komisioneve të marrjes në prova dhe rregullat e tjera të hollësishme.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.398, datë 24.10.1991 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 6.4.1985 "Për mbrojtjen e rrugëve dhe qarkullimin rrugor", si dhe neni 101 i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.129, datë 6.4. 1985, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi